

**THIRRJE E HAPUR LIDHUR ME STUDIMIN E TREGUT PËR PRODHIMIN EKZEKUTIV TË
9 EPISODEVE PËR NJË SERIAL ANTROPOLOGJIK NË KUADËR TË PROJEKTIT CIRCE,
FINANCUAR NGA PROGRAMI INTERREG IPA CBC ITALI-SHQIPËRI-MAL I ZI
2014-2020 (CUP B99D17019500007)**

Prezantim

Fondacioni Apulia Film Commission, krijuar në bazë të Ligjit Rajonal nr. 6/2004, nen. 7, ka luajtur një rol qendror në realizimin e politikave të Rajonit Pulia, në sektorin audiovizual, promocion dhe zhvillim; duke ofruar shërbime publike nga të cilat përfiton i gjithë territori i rajonit; duke punuar për të tërhequr produksione italiane dhe të huaja në Pulia, në mënyrë që të promovojë dhe t'u shtojë vlerat trashëgimisë artistike dhe mjedisore, memorjes historike dhe traditave të komuniteteve puljeze, burimeve teknike dhe profesionale aktive në territorin rajonal; duke mbështetur prodhimin dhe distribuimin e materialeve audiovizuale të realizuara në rajon, sidomos atyre të financuar nga Fondi i Filmit; duke promovuar iniciativat, eventet dhe festivalet e lidhura me audiovizualin në Pulia; duke kultivuar kërkimet shkencore, studimet, eksperimentimet dhe trajnimin e kompetencave në sektorin audiovizual; duke promovuar koordinimin e aktiviteteve mes institucioneve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat mbështesin bashkëpunimet në sektorin audiovizual dhe atë të teknologjive të komunikimit.

Duke përmbushur detyrat e veta, Fondacioni Apulia Film Commission është Përfituesi Kryesor i projektit **CIRCE** (*Common Initiatives to pRomote CinEma across Italy – Albania – Montenegro*), financuar nën thirrjen e parë të projekteve të Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi, Programi 2014/2020 (Prioritet Axis 2 ("Menaxhim i mençur i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, për shfrytëzimin dhe mbështetjen e turizmit ndër-kufitar dhe krijimin e produkteve inovative kulturore dhe kreative").

CIRCE përballet me një sfidë të përbashkët në të gjithë territoret e përfshira në programin Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi: modernizimin e sistemeve produktive territoriale të zonave të përfshira, duke investuar në industritë kulturore dhe kreative si burime strategjike kyçe për ti dhënë shtysë rritjes ekonomike të rajoneve të targetuara. Objektiva e përgjithshme kryesore është zgjerimi i kushteve për rritjen e industrive kulturore dhe kreative të sektorit audiovizual, të cilat mund t'i japin vlera trashëgimisë kulturore të zonave të përfshira, duke implementuar iniciativa ndër-kufitare që mund të ngrenë një urë mes rajoneve pjesëmarrëse dhe mbledhin aktorët kyçë për realizimin e produksioneve kreative. Projekti zbaton një program gjithëpërfshirës iniciativash ndër-kufitare në sektorin audiovizual duke përhapur politika të reja mbështetëse dhe duke ngritur përgjatë niveleve të ndryshme network-e ku do të përfshihen palët më të interesuara.

Përveç Fondacionit Apulia Film Commission, partnerë të tjerë në projekt janë Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Film Centre of Montenegro dhe Rajoni Molise. Partnerë të asociuar janë: Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Shqipërisë dhe MIBACT: Ministria e Trashëgimisë, Kulturës dhe Turizmit.

Në veçanti, në kuadër të **WPT1**, projekti **CIRCE** parashikon një serial antologjik për web mbi temën e udhëtimit, në mënyrë që të promovojë trashëgiminë arkitektonike, kulturore dhe artistike të territoreve të përfshira.

Prandaj, qëllimi i serialit web është të forcojë vizibilitetin dhe aftësinë njohëse të Shqipërisë, Malit të Zi, Rajonit Molise dhe Rajonit të Pulias nëpërmjet mjeteve audiovizuale, duke ja ngarkuar këtë detyrë regjisorëve nën 35 vjeç prej territoreve të përfshira, duke i bërë ata

protagonistë të zhvillimit kulturor të vendit të tyre.

Neni. 1– Tema e studimit të tregut

Ky studim tregu do të zbatohet në përputhje me nenin 36, paragraph 2, letter a) dhe nenin 63, paragraph 2, gërma b), pika 1 të Dekretit Legjislativ nr. 50/2016 (Kodi i Prokurimeve Publike).

Ky studim ka për qëllim të identifikojë të paktën nëntë operatorë ekonomikë të veçantë, të cilët do të realizojnë një episod për një seri web me kohëzgjatje jo më pak se 10 minuta (pa kreditet) – mbi temën e përcaktuar në Art 2 të kësaj thirrjeje.

Xhirimet do të zhvillohen në territorin e Shqipërisë dhe/ose Malit të Zi dhe/ose Rajonit Molise dhe/ose Rajonit Pulia.

Për më tepër, operatorët ekonomikë do të bashkëpunojnë me një regjisor të lindur ose rezident në Shqipëri dhe/ose Mali i Zi dhe/ose Rajoni Molise dhe/ose Rajoni Pulia. Regjisori duhet të jetë 35 vjeç në afatin e mbylljes së aplikimit.

Për këtë, Fondacioni Apulia Film Commission, do të kontraktojë 9 produksione ekzekutive të veçanta, duke rezervuar për vete pronësinë e plotë të punës dhe gjithë të drejtat e shfrytëzimit.

Operatorët ekonomikë që do të identifikohen në bazë të kriterit në art.5, do të ftohen për negociata me Apulia Film Commission në lidhje me gjithë aspektet specifike të punës audiovizuale (tema, produksioni, buxheti, etj.) dhe, vetëm në rast të negociatave të suksesshme, Fondacioni do të lidhë një kontratë produksioni ekzekutiv me secilin operator ekonomik. Për këtë, operatorët ekonomikë të identifikuar në bazë të këtij studimi tregu, nuk do të kenë asnjë pretendim mbi të drejtat dhe/ose pritshmëritë nëse faza e negociatave nuk mbaron me lidhjen e kontratës.

Ndërmjet nëntë episodeve të prodhuara, të paktën tre do të kenë regjisor shqiptar, tre regjisor malazez dhe tre regjisorë nga Rajoni Molise dhe/ose Rajoni Pulia.

Shuma maksimale për produksionin ekzekutiv të secilit episod, është € 20,000.00 (njëzetmijë euro), plus TVSH siç parashikohet nga ligji.

Art.2 – Elementë të filmit të shkurtër që do të realizohet.

Secili operator ekonomik, sëbashku me regjisorin e vet, do të zhvillojnë një propozim kreativ dhe original episodin e seriali për web, duke ndjekur tematikën e mëposhtme:

"Historitë mund të jenë zhanër fikcion ose drama ose animacione mbi temën e udhëtimit në gjithë aspektet e veta. Udhëtimi nënkuptohet si aventurë, arratisje, pushime ose udhëtime pune, por gjithashtu edhe si udhëtim i brendshëm, udhëtim në kohë ose udhëtim virtual. Udhëtimi si ëndërr ose nevojë. "

Punët audiovizuale duhet të respektojnë kërkesat e mëposhtme minimale të kualitetit teknik:

- a. Xhirime në gjuhën origjinale me subtitra anglisht ose vice versa;
- b. Kohëzgjatje maksimale 10 minuta (pa kreditet e hyrjes dhe mbylljes);
- c. Minimumi i formatit të xhirimit: 2K @ 25fps or 24fps: 2048x1152 pxs me referencë a.r. 2.39:1 (2048x858);
- d. Kodi i formatit të xhirimit:
 - i. Raw data;
 - ii. 4:4:4 sampling scheme;
 - iii. 4:2:2 sampling scheme;
- e. Ruajtja e materialit:
 - i. Nr.1 Hard drive me materialin origjinal;

- ii. Nr.1 Hard drive me projektin e edituar (sound të skenave të edituara) dhe projektin final (colour grading – mix – materiale grafike te crediteve- text files me kreditet e hapjes dhe mbylljes);
- iii. Nr.1 Hard drive containing:
 - Master file V.O. 4:4:4 (minimum 2K);
 - Master file V.O. with English subtitles 4:4:4 (minimum 2K);
 - Mix audio file single channels (6 or 2 channels + stem separate dialogues, music and effects);
 - Subtitles in srt format;
- iv. Scene and backstage photos.

Sa i përket buxhetit për produksionin ekzekutiv, duhet të respektohen rregullat e mëposhtme:

- Jo më pak se 15% do t'i atribuohet regjisorit të ri;
- Jo më shumë se 20% do t'i atribuohen aktorëve.

Për më tepër, mbi çështjen e buxhetit, rekomandohet që fee-të e përgjithshme dhe fee-të e produksionit të mos jenë më shumë se 15%.

Përdorimi i pamjeve ekzistuese është i ndaluar. Në rrethana të jashtëzakonshme, kjo çështje mund të negociohet dhe autorizohet vetëm dhe ekskluzivisht pas fazës së negociimit.

Përsa i përket komunikimit dhe kërkesave publicitare, çdo tenderues fitues do të përfshijë emblemën e Bashkimit Europian bashkë me logot e Interreg IPA CBC Italy-Albania-Montenegro Programme 2014/2020 dhe ato të partnerëve të projektit CIRCE në kreditet e hapjes dhe/ose mbylljes të punës, si dhe në të gjitha materialet që do të prodhohen.

Fondacioni Apulia Film Commission do të kontrollojë zbatimin e këtyre kërkesave.

Art. 3 – Kërkesat për pjesëmarrje në studimin e tregut

Aplikimi për të marrë pjesë në këtë studim të tregut duhet të prezantohet nga një operator ekonomik që prodhon vepra audiovizuale, i cili në datën e dorëzimit të aplikimit, përmbush kërkesat e mëposhtme:

- a. Të jetë regjistruar në Regjistrin Tregtar të vendit pjesëmarrës
- b. Të zotërojë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në art. 80 of Leg. Decree no. 50/2016;
- c. Të punojë kryesisht në sektorin e "Aktivitete në fushën e prodhimit të filmit, video dhe programme televizive" (kodi ATECO 2007 J 59.11, kodi NACE J 59.11 ose ekuivalentin jo-Europian);
- d. Të mos jetë përfitues i kontributeve dhe/ose fondeve të tjera për të njëjtën vepër audiovizuale, që merr pjesë në këtë studim tregu;
- e. Në rastin e operatorëve ekonomik nga Shqipëria dhe Mali i Zi, ata duhet të jenë të regjistruar në regjistrat specifikë kombëtar, siç është referuar në Annex XI të Dekretit Ligj. n. 163/2006 (Qendra e Biznesit Kombëtar në Shqipëri dhe Regjistrin Qendror të Entiteteve Komerciale në Malin e Zi) në përputhje me rregullat ekzistuese në vensin e rezidencës, ndërsa operatorët ekonomikë shqiptarë duhet të jenë të regjistruar edhe pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Çdo operator ekonomik mund të aplikojë për prodhimin ekzekutiv të maksimumi një episodi të serialit web. Nëse operatori ekonomik dërgon më shumë se një aplikim, të gjithë aplikimet e dorëzuara nga ky operator do të skualifikohen.

Çdo operator ekonomik do të tregojë në aplikim emrin dhe të detajet e regjisorit (lindur ose rezident në territorin e Shqipërisë ose Malit të Zi ose Rajonit Molise ose Rajonit Pulia, dhe nën 35 vjeç në datën e përfundimit të afatit të aplikimit) që do të realizojë episodin.

Çdo regjisor mund të marrë pjesë në thirrjen publike, i lidhur me një operator ekonomik. Nëse një regjisor i ri merr pjesë në këtë thirrje me më shumë se një operator ekonomik, gjithë aplikimet e saj/tij do të

skualifikohen.

Art. 4 – Rregullat e pjesëmarrjes

Operatorët ekonomikë të interesuar mund të dërgojnë aplikim e tyre nëpërmjet platformës digjitale në dispozicion në linkun <http://dev.hsh.it/afc/> jo më vonë se **23:59 (UTC + 1) 27 maj 2019** (45 ditë pas publikimit të thirrjes).

Aplikimet e dërguara pasafatit të përmendur ose dërguar në mënyra të tjera, do të skualifikohen.

Në veçanti, operatori ekonomik duhet të aplikojë nëpërmjet platformës, me dokumentat e mëposhtme **në gjuhën angleze** dhe në format pdf jo- të editueshëm.

- a. Formulari i Aplikimit (Annex 1);
- b. *Profili i Kompanisë* (curriculum) së operatorit ekonomik;
- c. *Curriculum vitae* i producentit;
- d. Kopje e një dokumenti të vlefshëm identifikimi të përfaqësuesit ligjor të operatorit ekonomik;
- e. Skenari origjinal (minimum 5 faqe);
- f. Shënimet e regjisorit (i.e. raporti i regjisorit që sqaron aspektet vizuale, estetike dhe artistike që përdoren si shtesë për atë që raportohet ndërkohë në skenar);
- g. Shënimet e Producentit (i.e. raporti i producentit që ekzaminon implementimin e elementëve të projektit, duke specifikuar mënyrën e punës dhe zgjidhjet eventuale për të përballur vështirësitë që përmban projekti);
- h. *Curriculum vitae* e regjisorit duke theksuar backgroundin e edukimit me reference të shkollës së kinemasë që ka ndjekur, filmografisë dhe pjesëmarrje në festival (regjisori inkurajohet të dorëzojë një link me një *showreel*/të punëve të mëparshme);
- i. Kopje e një dokumenti të vlefshëm identifikimi të regjisorit;
- j. Buxheti total i projektit, që respekton rregullat e përcaktuara në art. 2 (shuma totale e buxhetit nuk duhet të kalojë € 20.000,00, pa TVSH);
- k. Propozimi ekonomik (Annex 2) nuk duhet të përfshijë TVSH-në por duhet të përfshijë çdo takes/fee tjetër të cilat nuk duhet të kalojnë vlerën € 20.000,00.

Nëse nuk dorëzohen gjithë dokumentat e kërkuara në anexx-et, aplikimi konsiderohet i pavlefshëm.

Duke dorëzuar aplikimin, aplikantët njohin dhe pranojnë gjithë rregullat, shënimet dhe kërkesat e paraqitura në këtë thirrje.

Art. 5 – Kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit të projekteve.

Projekt-Menaxheri do të pregatisë kontratën e furnizimit pas vlerësimit të projekteve nga një Komitet specific, në bazë të një liste me pike (maximum 100 pikë) dhënë në përputhje me kriteret e përmendura më lart. Komiteti vlerësues caktohet nga Projekt-Menaxheri dhe do të përbëhet nga individë me eksperiencë të njohur, kompetencë dhe autoritet.

Kontrata e furnizimit do të pregatitet për aplikantët që kanë paraqitur projektin më të mirë, përcaktuar me kriteret e ofertës me avantazhin më të madh ekonomik, në bazë të listës së kriterëve të mëposhtme dhe koeficientëve respektivë:

- Kualitet i projektit filmik (maks 80 pikë)
- Oferta Ekonomike (maks 20 pikë).

Kriteret e vlerësimit të projektit janë si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit të kualitetit të projektit filmik	Maksimum
Origjinaliteti dhe kreativiteti e skenarit dhe and përputhja me tematikën	50
<i>Curriculum Vitae</i> e operatorit ekonomik dhe producentit	10
<i>Curriculum Vitae</i> e regjisorit	10
Saktësia dhe koherenca e projektit me buxhetin e propozuar.	10
TOTALI	80

Në mënyrë që çdo projekt të vlerësohet për çdo parameter, do të merret parasysh marrëdhënia ndërmjet vlerësimit kualitativ dhe koeficientëve të specifikuar më poshtë; këta të fundit do të shumëzohen me vlerësimin maksimal korrespondues, të përcaktuar pësecilin kriter vlerësimi:

KOEFIÇIENTËT E VLERËSIMIT KUALITATIV	
Shkëlqyeshëm	1,0
Shumë mirë	0,9
Mirë	0,8
Mesatar	0,7
Mjaftueshëm	0,6
Pothuajse mjaftueshëm	0,5
Dobët	0,4
Shumë dobët	0,3
Pamjaftueshëm	0,2
I papërshtatshëm	0,1
I pavlerësueshëm	0,0

Përsa i përket alokimit të 20 pikëve të parashikuara për ofertën ekonomike, do të përdoret formula e "Korrelacionit invers" (ndërvarësia) të regresit (në bazë të çmimit).

Çmimi atëherë do të llogaritet mbi bazën e formulës së mëposhtme:

$$PE = P_{max} \times \frac{P_{min}}{P}$$

Ku:

PE = pikët e dhëna

P_{max} = pikët maksimale (20)

P = çmimi (vlera) ofruar nga aplikanti

P_{min} = çmimi më i ulët ndërmjet atyre të ofruar në këtë thirrje

Vlerësimi total i secilit projekt do të përcaktohet nga shuma e pikëve të marra për secilin parametër.

Projektet që vlerësohen me mbi 60 pikë do të përfshihen në listën finale.

Nëntë projektpropozimet në majë të listës do të përfshihen në fazën tjetër, nëse paraqesin parametrat sipas të cilave ka të paktën tre aplikime me regjisor shqiptar, tre me regjisor malazez dhe tre me regjisor nga Rajoni Molise dhe Pulia.

Në rast barazimi, do të kenë prioritet operatorët ekonomik me pikavarazhin më të madh për origjinalitet dhe kreativitet të skenarit dhe përputhje me tematikën. Në rast se vazhdon barazimi, do të ketë prioritet operatori ekonomik me regjisorin më të ri. Në rast barazimi tjetër, fituesi do të zgjidhet me short.

Në fund të procedurës së negociatave, Apulia Film Commission do t'i ofrojë një kontratë prodhimi ekzekutiv secilit operator ekonomik, duke duke rezervuar për vete pronësinë e plotë të punës dhe gjithë të drejtat e shfrytëzimit.

Nëse faza e negociatave nuk mbyllet me dhënien e kontratës për një ose më shumë operatorë ekonomikë, Fondacioni Apulia Film Commission mund të pranojë të negociojë me projektet e tjera sipas renditjes në listë, duke respektuar gjithmonë parametrat e parashikuar.

Përsërisim se operatorët ekonomikë të renditur më poshtë në listë, nuk mund të kenë asnjë pretendim mbi të drejtat dhe/ose pritshmëritë nëse faza e negociatave nuk mbaron me lidhjen e kontratës.

Përtej kësaj, ritheksojmë se Apulia Film Commission mund të ndërhyjë në draftin e 9 skenarëve finale dhe në vendimet artistike dhe të prodhimit, në mënyrë që të ndërtojë sekuencë e episodeve. Për më tepër, në mënyrë që të krijojë një unitet të serialit, Fondacioni Apulia Film Commission, web, do të organizojë disa takime në të cilat, autorët dhe producentët e përzgjedhur janë të detyruar të marrin pjesë.

Art. 6 – Kalendari i aktiviteteve

Skedula e aktiviteteve në lidhje me thirrjen është si më poshtë:

- a. Brenda 30 ditëve nga skadimi i afatit të aplikimit, do të publikohet lista me operatorët ekonomik të përzgjedhur, që kanë kaluar në fazën e negociatave.
- b. Deri në mes të korrikut 2019, finalizimi i fazës së negociatave dhe fillimi i përgatitjes;
- c. Deri në fund të korrikut 2019, do jenë firmosur kontratat dhe fillon puna pas dorëzimit të versioneve finale të: planit të punës, listës së ekipit, teknikës, kostove të parashikuara;
- d. Der në shtator 2019, përfundimi i punëve dhe fillimi i post-prodhimit pas dorëzimit të planit të post-prodhimit;
- e. Deri në 15 tetor 2019, projeksioni i kopjes së filmit;
- f. Deri në tetor 2019, Fondacioni Apulia Film Commission paraqet kërkesën për ndryshime të mundshme;
- g. Deri në 10 nëntor 2019, finalizimi i post-prodhimit me ndryshimet e kërkuara, përfshirë, *colour correction* dhe subtitrimin në gjuhën angleze ose në gjuhën origjinale;
- h. Deri në Nëntor 2019, finalizimi i aktiviteteve, me dorëzimin e produktit final te Fondacioni Apulia Film Commission.

Në momentin e nënshkrimit të kontratës, Fondacioni Apulia Film Commission do të ndërhyjë në çdo hap të zbatimit të punës që lidhet me monitorimin e aktiviteteve dhe supervizimin e prodhimit dhe prcetit artistik nëpërmjet një deleguarit të prodhimit.

Pagesat do të bëhen me fatura të rregullta elektronike (për operatorët italianë) si më pas: 100% e balancës në mbyllje të aktiviteteve të përcaktuara. Secilit operator ekonomik do t'i jepet mundësia e një 50%-i të shumës së akorduar, me aprovim nga i deleguari i prodhimit dhe projekt-menaxheri, pas dorëzimit të hard diskut që përmban xhirimet dhe drive-t direkt dhe dorëzimit të faturës përkatëse.

Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga marrja e faturës origjinale. Fondacioni Apulia Film Commission nuk mban përgjegjësi në rast të vonesave në pagesë për arsye që nuk i takojnë Fondacionit.

Faturat duhet të përmbajnë një referencë të qartë të CUP dhe IGC, të cilat do i përcaktohen ne përputhje me legjislacionin që etablon kërkesat e gjurmimit të lëvizjeve financiare. (art. 3, Ligji nr. 136/2010, dhe sipas amendimeve në Ligjin nr. 217/2010) dhe të IBAN dhe kodit SWIFT të nevojshëm për transfertën. Fondacioni Apulia Film Commission i nënshtrohet ndarjes së pagesës sipas art.1 of L.D. 50 dt. 24/04/17, prandaj edhe pagesa e operatorëve ekonomik to të ndahet.

Faturat duhet të përfshijnë vlerën e taksueshme (dhënë direkt nga Fondacioni Apulia Film Commission, operatorit ekonomik) dhe shumën e TVSH, if due (nëse Fondacioni do të depozitojë në thesar sipas legjislacionit ekzistues), dhe referencës "Pagesë e ndarë- art.1 LD 50/2017" .

Faturat duhet ti adresohen:

Apulia Film Commission Foundation

Cineporti di Puglia/Bari, c/o Fiera del Levante, Lungomare Starita 1, 70132 Bari, Italy

Social Security Number 93332290720 - VAT 06631230726

Objekti: Executive production of [title of audiovisual work] in the frame of CIRCE project financed under the first call for ordinary projects of INTERREG IPA CBC Italy-Albania-Montenegro Programme 2014/2020- CUP B99D17019500007 – CIG (përcaktohet në kontratë).

Art. 7 – Informacion në përpunimin e të dhënave personale

Në përputhje me art. 13 të EU Regulation 2016/679 (GDPR), të dhënat personale do të përpunohen nga Fondacioni Apulia Film Commission ekskluzivisht për zbatimin e procedurës aktuale dhe ato do të ruhen në arkiva fizikë dhe elektronikë. Këto të dhëna mund t'i komunikohen administratës publike ose entiteteve legale të përfshira drejtpërdrejt. Një referencë për të dhënat personale është e detyrueshme për pjesëmarrjen në këtë thirrje publike. Si subjekt i këtyre të dhënave, pjesëmarrësit kanë mundësinë të ushtrojnë të drejtën e tyre (siç parashikohet në art. 15 GDPR), duke i shkruar adresës privacy@apuliafilmcommission.it. Kontrollin e përpunimit të të dhënave e ka Fondacioni Apulia Film Commission.

Art. 8 – Informacione të tjera

Për të zhvilluar aktivitetet, Fondacioni Apulia Film Commission do t'u ofrojë tenderuesve të suksesshëm në zyrat e tyre, administratave, organeve të tyre dhe palëve të interesuara përfshirë në aksionet e lidhura me aktivitetin. Për më tepër Apulia Film Commission merr përsipër të bëjë të aksesueshëm të gjithë të dhënat dhe informacionin që shërben për zbatuar aktivitetet.

Tenderuesit e suksesshëm do të:

- a. Garantojnë ekzekutimin e aktiviteteve të planifikuara së bashku me zyrat kompetente të Apulia Film Commission dhe palëve të tjera të interesuara, sipas skedulës së përcaktuar dhe nevojave;
- b. T'i njohë Apulia Film Commission pronësi të plotë të veprës dhe të drejtave të shfrytëzimit;
- c. Të mos përdorë, as direkt, as indirekt mandatin e dhënë dhe informacionin që përmban për përfitim personal ose të një pale të tretë, edhe pas skadimit të kontratës.
- d. Të transferojë te Fondacioni Apulia Film Commission gjithë rezultatet, metodat dhe teknologjitë e përdorura.

Për më tepër, tenderuesit e suksesshëm duhet të përmbushin kërkesat mbi gjurmimin e lëvizjeve financiare sipas art. 3 of Ligji of 13 August 2010, n. 136, dhe amendimeve të bëra, duke marrë përsipër të informojnë Fondacionin Apulia Film Commission dhe autoritetet përkatëse mbi eventual counterparty default mosplotësimin eventual (si nënkontraktorë) të gjurmimit financiar.

Kështu, tenderuesi i suksesshëm duhet të përfshijë kodin unik të projektit (CUP B99D17019500007) dhe numrin identifikues të thirrjes (CIG) në gjithë dokumentat e ardhshme që lidhen me zbatimin e kontratës, përfshirë edhe fatura pagesash.

Tenderuesi i suksesshëm merr përsipër të respektojë dhe përdorë art. 25 të Ligji Rajonal 25/2007 dhe art. 30 të Ligji 4/2010, përpos rregullave të Ligji Rajonal 26 tetor 2006, nr. 28 dhe rregullores së aprovuar nr.31 të 2009, e cila siguron për "detyrimin për të përdorur kontratat kolektive kombëtare dhe rajonale të sektorit" dhe "shkelje e vërtetuar e këtij detyrimi, nënkupton përjashtimin nga pagesat e planifikuara".

Pas shpalljes së fituesve, Fondacioni Apulia Film Commission do të ftojë tenderuesit e suksesshëm të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm për mbylljen e kontratës. Gjithësesi, mbyllja e kontratës varet nga:

- a. Verifikimi që nuk ka pengesa në dhënien e kontratës, siç parashikohet nga Ligji i 31 maj 1965 nr. 575 dhe gjithë amendimet apo shtesat e tij.
- b. Verifikimi i deklaratave të bëra gjatë procedurës së tenderimit dhe sigurimi i çertifikatave të nevojshme. Përfshirë edhe çertifikatën e rregullsisë së kontributit.

Nëse pas dhënies së kontratës, ose gjatë zbatimit të shërbimeve, nuk përmbushen kërkesat e përshkruara në thirrjen publike, kjo çon në terminim të hershëm të marrëdhënies, duke përjashtuar çdo kërkesë për dëmshpërbim nga Fondacioni Apulia Film Commission.

Apulia Film Commission Foundation ruan të drejtën të verifikojë në çdo kohë cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Në rast të ndonje mos-pajtimi dhe/ose mungese cilësie të shërbimeve të ofruara, Fondacioni Apulia Film Commission do të paralajmërojë kontraktuesin, nëpërmjet email-it ose mënyrave të tjera të ngjashme, të përmbushë kërkesat e nevojshme ofruar nga kontrata, brenda një afati të detyrueshëm 10-ditor. Nëse kontraktuesi dështon ta bëjë, Apulia Film Commission mund të terminojë me të drejtë kontratën, duke i hequr kontraktorit çdo të drejtë ankese.

Në rast të ndërprerjes së kontratës, Fondacioni Apulia Film Commission, mund të vazhdojë bashkëpunimin me ata që janë më poshtë në listë.

Çdo polemikë e çdo lloji dhe natyre, që lind mes Fondacionit Apulia Film Commission dhe tenderuesve të suksesshëm, është në kompetencën e autoriteteve ligjore të Foro di Bari.

Gjithë dokumentat janë në website www.apuliafilmcommission.it dhe në zyrat e Fondacionit Apulia Film Commission : Cineporti di Puglia/Bari c/o Fiera del Levante, Lungomare Starita 1, 70132 Bari.

Elementët që nuk përcaktohen në këtë thirrje, do të sqarohen me dispozitat ligjore relevante.

Kërkesa për sqarime mbi procedurën në fjalë duhet të dërgohet në adresën e mëposhtme: cristina.piscitelli@apuliafilmcommission.it para 20 ditëve të fundit të afatit të aplikimit.

Përgjigjet për pyetjet e prashtruara do të publikohen në web-faqen www.apuliafilmcommission.it, në seksionin specifik të kësaj thirrjeje.

Menaxhere e Projektit është znj. Cristina Piscitelli, përgjegjëse për Projekte të EU dhe Financime të Fondacionit Apulia Film Commission.

Bari, 12 prill 2019

Prot. N° 1133/19/U

Cristina Piscitelli

Përgjegjëse për Projekte të EU dhe Financime
Fondazione Apulia Film Commission